

**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPLLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

**Inspektor, Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit, Sektori i Inspektimit (Kategoria III-b).**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

**Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ( Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

**Inspektori ka për detyrë si më poshtë:**

Inspektori varet nga Përgjegjësi i Sektorit në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit, Sektori i Inspektimit dhe ka këto detyra kryesore:

- Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Realizon kontrollin në territorin e Bashkisë Tiranë në lidhje me situatën ndërtimore.
- Inspekton në mënyrë të vazhdueshme objektet me leje ndërtimi sipas përcaktimeve nga Drejtori i Drejtorisë dhe Kryeinspektori.
- Mban Procesverbal të Konstatimit mbi kontrollin e ushtruar në rastet kur konstatohen kundërvajtje administrative, shoqëruar me relacionin përkatës ku parashtrohet gjëndja aktuale në subjekt dhe sugjerimet për masën administrative që do të ndërmerret.

- Regjistrion të dhënat për të gjitha subjektet ku konstatohet shkelje administrative dhe ndërtim pa leje (shoqëruar me foto të objekteve në ndërtim si provë e shkeljes administrative);
- Nëshkruan procesverbalet e konstatimit;
- Trajton ankesat e marra nga insitucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizikë e juridik. Merr masat për zgjidhjen e tyre.

**Dokumentat që aplikanti për Inspektor në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit, Sektori i Inspektimit duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë ( Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Vërtetim i aftë për punë;
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 12.02.2025 **ora** 16.30.